

Në bazë të nenit 18 paragrafi 1 alineja 8, neni 20 paragrafi 1 alineja 11, në lidhje nenin 41 paragrafi 11 nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14), dhe nenin 15 paragrafi 1 alineja 8 nga Rregullorja e punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele nr. 01-4351/1 nga data 19.11.2014, Këshilli i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele në mbledhjen e 18-të të mbajtur më 19.11.2014, miratoi:

RREGULLORE PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E NJOFTIMIT PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË PRONARËVE

Neni 1

Me këtë Rregullore, rregullohet forma dhe përmbajtja e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronarëve që radiodifuzerët janë të obliguar që ta dorëzojnë deri te Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (në tekstin e mëtejme: Agjencia).

Neni 2

Radiodifuzerët nuk guxojnë që të bëjnë zbatimin e strukturës së pronarëve pa njoftim paraprak të Agjencisë dhe para se e njëjta të miratohet nga Agjencia.

Neni 3

Radiodifuzerët janë të obliguar që njoftimin për ndryshimin e planifikuar të strukturës së pronarëve ta dorëzojnë deri te Agjencia në një formular të veçantë, i cili është në shtesë të kësaj Rregullore (Formulari PSS/1 – shtesa nr. 1).

Formulari nga paragrafi 1 i këtij neni i përmban këto të dhëna:

1. Emrin e plotë të radiodifuzerit
2. Numrin e vetëm amë të subjektit/radiodifuzerit
3. Numrin tatimor të radiodifuzerit
4. Selinë e radiodifuzerit
5. Të dhënat për strukturën aktuale pronësore të radiodifuzerit
 - 5.1. Emrin dhe mbiemrin, NVAQ, adresën dhe pjesëmarrjen në kryegjënë bazë të radiodifuzerit (nëse themelues janë persona fizik), respektivisht
 - 5.2. Emrin e plotë, NVAS, selinë dhe pjesëmarrjen në kryegjënë bazë të radiodifuzerit (nëse themelues janë persona juridik) dhe të dhëna për themeluesit e personave juridik që janë të themelues të radiodifuzerit (emri dhe mbiemri NVAQ, adresa dhe pjesëmarrja në kryegjënë bazë të personit juridik).
6. Të dhënat për ndryshimin e planifikuar në strukturën e pronarëve të radiodifuzerit
 - 6.1. Të dhëna për personat fizik dhe/ose juridik që dalin nga struktura e pronarëve të radiodifuzerit (emri dhe mbiemri/i plotë NVAQ NVAS, adresa/selia dhe pjesëmarrja në kryegjënë bazë të radiodifuzerit).
 - 6.2. Të dhëna për personat fizik dhe/ose juridik që hyjnë në strukturën e pronarëve të radiodifuzerit

- 6.2.1. Emri dhe mbiemri, NVAQ, adresa dhe pjesëmarrja e planifikuar në kryegjënë bazë të radiodifuzerit (nëse është person fizik), respektivisht
- 6.2.2. Emrin e plotë, NVAS, selia dhe pjesëmarrja në kryegjënë bazë të radiodifuzerit (nëse është person juridik) si dhe të dhëna për themeluesit e personave juridik (emri dhe mbiemri NVAQ, adresa dhe pjesëmarrja në kryegjënë bazë të personit juridik).
- 7. Të dhënat për strukturën e pronarëve të radiodifuzerit që do të krijohen nga ndryshimi i planifikuar:
 - 7.1. Emrin dhe mbiemrin, NVAQ, adresën dhe pjesëmarrjen në kryegjënë bazë të radiodifuzerit (nëse themelues janë persona fizik), respektivisht
 - 7.2. Emrin e plotë, NVAS, selia dhe pjesëmarrja në kryegjënë bazë të radiodifuzerit (nëse themelues janë persona juridik) dhe të dhëna për themeluesit e personave juridik që janë të themelues të radiodifuzerit (emri dhe mbiemri NVAQ, adresa dhe pjesëmarrja në kryegjënë bazë të personit juridik).

Neni 4

Njoftimit të tyre, radiodifuzerët janë të obliguar që ti bashkëngjisin:

1. Deklaratë të vërtetuar në noter nga personi fizik ose juridik që hyn si pronar (deklaratë japin menaxheri/ drejtori) dhe themeluesi/t e personit juridik) se me hyrjen e tyre nuk i shkelin dispozitat nga kreu IV i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (shtesa nr. 2 dhe shtesa nr. 3);
2. Deklaratë të vërtetuar në noter nga radiodifuzeri (deklaratën e jep menaxheri i radiodifuzerit) se me ndryshimin e planifikuar të strukturës së pronarëve nuk shkelen dispozitat nga neni IV i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuele (shtesa nr. 4);
3. Gjendja aktuale e radiodifuzerit, e marrë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë (jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e lëshimit);
4. Gjendja aktuale për personin juridik që hyn dhe dokument për veprimtari të regjistruar (formulari DRD) të dhëna nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë (jo më të vjetra se 15 nga dita e lëshimit);
5. Nëse në strukturën e pronarëve të radiodifuzerit, hyn një person i huaj juridik, radiodifuzeri është i obliguar që të dorëzojë dokument për regjistrimin e këtij personi juridik në regjistrin adekuat në vendin ku është i regjistruar, nga ku mund të mësohen informatat për themeluesin/it dhe menaxherin (jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e lëshimit, në origjinal dhe të përkthyer në gjuhën maqedonase nga përkthyes i autorizuar gjyqësor, kurse përkthimi të vërtetohet në noter);
6. Autorizim të vlefshëm nëse kërkesa parashtrohet përmes personit të autorizuar.

Neni 5

Radiodifuzerët janë të obliguar që pas kërkesës me shkrim të Agjencisë të dorëzojnë edhe dokumente dhe të dhëna tjera që janë me rëndësi për vendimmarrje ndaj njoftimit të parashtruar për strukturën e pronarëve.

Neni 6

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e ardhshme pas ditës së publikimit në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë"

Neni 7

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregullore, pushon vlefshmëria e Udhëzimit për formën dhe përmbajtjen e njoftimeve dhe kërkesave të radiodifuzerëve, në lidhje me ndryshimet në strukturat e pronarëve dhe për llojin dhe formën e të dhënave për punën ekonomike-financiare të punës, që radiodifuzerët janë të obliguar që ti dorëzojnë deri te Këshilli për radiodifuzion ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 53/08 dhe 41/13).

Nr. _____
audio dhe audiovizuale
_____2014
Shkup

Agjencia për shërbime mediatike

Kryetar i Këshillit

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v

Nr. _____

**NJOFTIM
PËR NDRYSHIMIN E STRUKTURËS SË PRONARËVE**

nga _____
(emri i plotë të radiodifuzerit)

EMBS _____ numri tatimor _____

_____ (adresa dhe selia)

GJENDJA AKTUALE E STRUKTURËS SË PRONARËVE TË RADIODIFUZERIT:

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

(nëse ka më shumë pronarë)

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

NDRYSHIMI I PLANIFIKUAR I STRUKTURËS SË PRONARËVE:

Largohet:

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____

adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

Hyn:

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

STRUKTURA E PRONARËVE QË DO TË KRIJOHET NGA NDRYSHIMI I KËRKUAR:

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

(nëse ka më shumë pronarë)

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

TË DHËNA PËR THEMELUESIN E PERSONIT JURIDIK QË ANËTARËSOHET:

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

Emri dhe mbiemri/titulli _____
NVAQ/NVAS _____
adresa/selia _____
pjesëmarrja në kryegjënë bazë _____ den. respektivisht _____%

Shkup, _____

Shtesa (6):

1. Deklaratë të vërtetuar në noter nga personi fizik ose juridik që hyn si pronar (deklaratë japin menaxheri/ drejtori) dhe themeluesi/t e personit juridik) se me hyrjen e tyre nuk i shkelin dispozitat nga kreu IV i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (shtesa nr. 2 dhe shtesa nr. 3);
2. Deklaratë të vërtetuar në noter nga radiodifuzeri (deklaratën e jep menaxheri i radiodifuzerit) se me ndryshimin e planifikuar të strukturës së pronarëve nuk shkelen dispozitat nga neni IV i Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (shtesa nr. 4);
3. Gjendja aktuale e radiodifuzerit, e marrë nga Regjistri qendror i Republikës së Maqedonisë (jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e lëshimit);
4. Gjendja aktuale për personin juridik që hyn dhe dokument për veprimtari të regjistruar (formulari DRD) të dhëna nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë (jo më të vjetra se 15 nga dita e lëshimit);
5. Nëse në strukturën e pronarëve të radiodifuzerit, hyn një person i huaj juridik, radiodifuzeri është i obliguar që të dorëzojë dokument për regjistrimin e këtij personi juridik në regjistrin adekuat në vendin ku është i regjistruar, nga ku mund të mësohen informatat për themeluesin/it dhe menaxherin (jo më e vjetër se 15 ditë nga dita e lëshimit, në origjinal dhe të përkthyer në gjuhën maqedonase nga përkthyes i autorizuar gjyqësor, kurse përkthimi të vërtetohet në noter);
6. Autorizim të vlefshëm nëse kërkesa parashtrohet përmes personit të autorizuar.

V.V

Menaxheri,

DEKLARATË

Unë (emri dhe mbiemri) me adresë të vendbanimit (adresa e vendbanimit) me NVAQ (nvaq), në përgjegjësi të plotë morale, penale dhe materiale deklaroj se nuk ekzistojnë pengesa në aspekt të dispozitave të Kreut IV “Mbrojtja e pluralizmit dhe llojlojshmërisë së shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale” nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) që të arrij të drejtën për pjesëmarrje në pronësinë e (emri i plotë i radiodifuzerit).

Vendi

Data

Deklaroi

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi personal)

(për themeluesin e personit juridik)

DEKLARATË

Unë (emri dhe mbiemri) me adresë të vendbanimit (adresa e vendbanimit) me NVAQ (nvaq), në cilësinë e pronarit të (emri i plotë i personit juridik) në përgjegjësi të plotë morale, penale dhe materiale deklaroj se nuk ekzistojnë pengesa në aspekt të dispozitave të Kreut IV “Mbrotjtja e pluralizmit dhe llojllojshmërisë së shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale” nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) për (emri i plotë i personit juridik) që të arrij të drejtën për pjesëmarrje në pronësinë e (emri i plotë i radiodifuzerit).

Vendi

Data

Deklaroi

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi personal)

(për drejtuesin e personit juridik)

DEKLARATË

Unë (emri dhe mbiemri) me adresë të vendbanimit (adresa e vendbanimit) me NVAQ (nvaq), në cilësinë e drejtuesit të (emri i plotë i personit juridik) në përgjegjësi të plotë morale, penale dhe materiale deklaroj se nuk ekzistojnë pengesa në aspekt të dispozitave të Kreut IV “Mbrotjtja e pluralizmit dhe llojlojshmërisë së shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale” nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14) për (emri i plotë i personit juridik) që të arrij të drejtën për pjesëmarrje në pronësinë e (emri i plotë i radiodifuzerit).

Vendi

Data

Deklaroi

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi personal)

DEKLARATË

Unë (emri dhe mbiemri) me adresë të vendbanimit (adresa e vendbanimit) me NVAQ (nvaq), në cilësinë e drejtuesit të (emri i plotë i personit juridik) në përgjegjësi të plotë morale, penale dhe materiale deklaroj se me hyrjen e (emri dhe mbiemri/i plotë) nuk ekzistojnë pengesa në aspekt të dispozitave të Kreut IV “Mbrotjtja e pluralizmit dhe llojllojshmërisë së shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale” nga Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14 dhe 132/14).

Vendi

Data

Deklaroi

(emri dhe mbiemri)

(nënshkrimi personal)